



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KRYEMINISTRIA  
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR  
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE

KËSHILLI KONSULTATIV  
QEVERISJE QENDRORE - VETËQEVERISJE VENDORE

Nr. 428 prot

Tiranë, më 25.6.2024

VENDIM

Nr. 4 datë 25.6.2024

PËR  
MIRATIMIN E PROJEKTAKTEVE OBJEKT KONSULTIMI NË MBLEDHJEN E  
KËSHILLIT KONSULTATIV, QEVERISJE QENDRORE – VETËQEVERISJE  
VENDORE TË DATËS 24/6/2024

Këshilli Konsultativ bazuar në Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, si dhe në VKM nr.244, datë 17.4.2024 “Për çështjet objekt konsultimi dhe strukturën, procedurën, formën, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, pas shqyrtimit të projektakteve të mëposhtme, të mbledhjes së datës 24.6.2024 vendosi:

1. Për projektvendimin “Për miratimin e strukturës dhe niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe punonjësve jomësimorë, në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar”, propozuar nga Kryeministria, Departamenti i Administratës Publike, anëtarët e Këshillit Konsultativ mbështetur në mendimet e tyre, shprehën dakordësinë në parim me projektvendimin.
2. Për projektvendimin “Për miratimin e vlerave për secilin element përbërës të pagës bruto mujore të punonjësve të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”,

propozuar nga **Kryeministria, Departamenti i Administratës Publike**, anëtarët e Këshillit Konsultativ u shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t'u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:

- Të llogariten në rritjen e pagave edhe orët e shërbimit natën dhe ditët e festave zyrtare për punonjësit zjarrfikës;
- Të llogaritet në rritjen e pagës për vështirësitë e punës e drejtuesit operacional me natyrë të veçantë pune;
- Të shoqërohet rritja e pagave me faturën financiare përkatëse.

3. Për projektvendimin **“Për disa ndryshime në Vendimin nr.336, datë 31.05.2006 “Për transferimin në pronësi, disa bashkive, të pronave, të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, dhe për disa ndryshime në Vendimin nr.60, datë 1.2.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror”**, propozuar nga **Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale**, anëtarët e Këshillit Konsultativ u shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t'u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:

- Të përcaktohen saktë dhe qartë detyrimet dhe përgjegjësitë e bashkive përkatëse.

4. Për projekturdrin **“Për disa ndryshime në Urdhrin nr.88, datë 25.10.2011 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Shërbimit Social Shtetëror, të ndryshuar”**, propozuar nga **Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale**, anëtarët e Këshillit Konsultativ u shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t'u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:

Duhet të jenë anëtarë e grupit të komisionit;

- Urdhëri i psikologut;
- Urdhëri i punonjësit social;
- Mediat lokale;
- Shërbimi i provës.

5. Për projektvendimin **“Për përbërjen, rregullat më të hollësishme të organizimit dhe funksionimit të Këshillave Vendor të Sigurisë Publike dhe Këshillit Kombëtar për Sigurinë në Komunitet”**, propozuar nga **Ministria e Brendshme**, anëtarët e Këshillit Konsultativ u shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t'u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:

- Për pikën 2 të vendimit, anëtarë të KVSP të jenë nga Drejtoria Vendore e Policisë.

6. Për projektvendimin **“Për ngritjen dhe funksionimin e Komitetit Teknik për**

**Migracionin, dhe monitorimin e zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Migracionin 2024-2030 dhe Planit të Veprimit të saj 2024-2026”,** propozuar nga **Ministria e Brendshme**, anëtarët e Këshillit Konsultativ u shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:

Në pikën III “Anëtarët e Komitetit Teknik” të shtohen në listë në mënyrë nominale:

- Shoqata e Këshillave të Qarqeve përfaqësuar nga Kryetari i Shoqatës dhe një kryetar tjetër qarku;
- Shoqata e Bashkive e përfaqësuar nga Kryetari i Shoqatës dhe një kryetar tjetër bashkie;
- Shoqata për Autonomi Vendore përfaqësuar nga Kryetari dhe një kryetar tjetër bashkie.

**Z. Arbjan MAZNIKU**  
Ministër i Shtetit për Pushtetin Vendor  
Bashkëkryetar

**Z. Aldrin DALIPI**  
Kryetar i Shoqatës së Këshillit  
të Qarqeve të Shqipërisë  
Bashkëkryetar